

VENDIM
Nr.1224, datë 3.9.2008

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË TRI AUTOKOLONAVE DHE TRUPAVE
USHTARAKE SLOVENE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - Porti i Durrësit, në datën 4 shtator 2008, të 3 (tri) autokolonave dhe trupave ushtarake slovene, të përbëra, përkatësisht:

- Autokolona e parë, me 19 (nëntëmbëdhjetë) automjete, të cilat përmbajnë armatim, municione dhe materiale ushtarake, si dhe 38 (tridhjetë e tetë) trupa ushtarake.
- Autokolona e dytë, me 25 (njëzet e pesë) automjete, të cilat përmbajnë armatim, municione dhe materiale ushtarake, si dhe 41 (dyzet e një) trupa ushtarake.
- Autokolona e tretë, me 22 (njëzet e dy) automjete, të cilat përmbajnë armatim, municione dhe materiale ushtarake, si dhe 34 (tridhjetë e katër) trupa ushtarake.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të jetë pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes të jetë pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit.

2. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre”, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

3. Autokolonat dhe trupat ushtarake slovene, gjatë itinerarit të lëvizjes nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha